

Komuna e Skenderajt: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Skenderajt që nga paslufta udhëhiqet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Aktualisht postin e Kryetarit në Komunën e Skenderajt e mban Sami Lushtaku i cili po e përmbyll mandatin e dytë në këtë pozitë.
2. Në Kuvendin Komunal, shumicën absolute të ulëseve e përbëjnë përfaqësuesit e PDK-së. Kësaj partie i takojnë 26 ulëse prej 31 sa janë gjithsej, tri ulëse janë për Lidhjen Demokratike të Dardanisë (LDD), ndërsa nga një ulëse e ndajnë Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Ekzekutivi i komunës përbëhet prej nëntë drejtorive.
3. Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Skenderaj ka 50.858 banorë.¹
4. Hulumtimi UNDP-së, Mozaiku i Kosovës 2012, tregon se 72% e banorëve të Skenderajt e konsiderojnë kompetente komunën për t'i zgjidhur problemet me të cilat ata ballafaqohen në vendbanimet e tyre, përderisa 21% mendojnë se vetëm pushteti qendror mund t'i zgjidh ato probleme.²
5. Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore në atë kohë në Komunën e Skenderajt kanë qenë papastërtia në qytet, mos funksionalizimi i Shtëpisë së Kulturës, mungesa e kanalizimeve, mungesa e ujit të pijes si dhe braktisja e shkollës nga nxënësit.³

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 150. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

³ Instituti GAP. Raporti Komunal. Komuna e Skenderajt. Nëntor 2009. Fq 3.

Burimi: http://www.institutigap.org/documents/13469_Skenderaj-raporti%20komunal.pdf

Problemet kryesore të Komunës së Skenderajt 2013

- 1. Mungesa e ujit të pijes.** Mungesa e ujësjellësit nëpër fshatrat e Komunës së Skenderajt paraqet problem për banorët. Vetëm qyteti i Skenderajt dhe 6 fshatra të tjera (Tërnaci, Prekazi, një pjesë e Llaushës, Klinë e Poshtme, Klinë e Mesme dhe Klinë e Epërme) e kanë në dispozicion rrjetin e ujësjellësit. Banorët e fshatit Mikushnicë me anë të vetë kontributeve kanë siguruar ujësjellësin. Fshatrat që nuk kanë ujësjellës janë Açahevë, Abri, Turiqevc, Baks, Burojë, Çirez, Çubrel, Dashec, Izbicë, Kotorr, Kryshec, Kuçicë, Leçinë, Makërma, Marinë, Novosellë, Pemishtë si dhe lagjja “Saraj” në Skenderaj. Edhe raporti i UNDP-së, tregon se vetëm 51% e familjeve në Skenderaj janë të lidhura me ujësjellësin publik. Prej kësaj përqindje, 37% kanë deklaruar se kanë furnizim të pandërprerë me ujë të pijes, 6% kanë ndërprerje nga 1 deri në 4 orë në ditë, po (6%) kanë ndërprerje prej 5 deri në 10 orë në ditë, ndërsa 40% kanë deklaruar se ndërprerjet gjatë ditës shkojnë më shumë se 11 orë në ditë.⁴
- 2. Mungesa e kanalizimit.** Ngjashëm si me problemin e ujësjellësit, edhe mungesa e kanalizimit përbën shqetësim të madh për banorët e Skenderajt. Përderisa qyteti i Skenderajt, fshati Prekaz dhe një pjesë e Klinës së Poshtme e kanë të rregulluar sistemin e kanalizimit, kjo nuk haset edhe në fshatrat tjera të kësaj ane. Fshatrat të cilat e kanë nivelin më të madh të ndotjes për shkak të mungesës së kanalizimit janë fshatrat Baks, Qirez, Kryshec, bashkësia lokale në Likoc dhe bashkësia lokale në Turiqec. Sipas hulumtimit të organizatës DEMI/USAID, 55% e banorëve të Komunës së Skenderajt janë të pakënaqur me gjendjen e kanalizimeve në vendbanimet e tyre.⁵
- 3. Menaxhimi i mbeturinave.** Ndotja e ambientit nga mbeturinat është një problem tjetër me të cilin përballen banorët e Komunës së Skenderajt. Vetëm në qytet ka kontejnerë prej të cilëve kompania “Pastrimi” e bën largimin e mbeturinave ndërsa në vendet e tjera jo. Banorët e “Lagjes së Re” në Skenderaj janë shprehur të rrezikuar nga një deponi e madhe e mbeturinave që gjendet në këtë lagje.⁶ Mbi katër deponi të mbeturinave janë në

⁴Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 148. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁵Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 23. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

⁶Klan Kosova, „Deponia e mbeturinave në Skenderaj, alarmon qytetarët”. Burimi :<http://WWW.klankosova.tv/index.php/lajme-nga-vendi/4607-deponia-e-mbeturinave-ne-skenderaj-alarmon-qytetaret.html>

fshatin Likoc, ndërsa në fshatin Prekaz i Ulët është një deponi tjetër e madhe e mbeturinave. Mbeturinat janë prezent edhe në fshatrat tjera të kësaj ane. Sipas raportit të UNDP-së, komuna e Skenderajt hyn në mesin e tri komunave të cilat janë më të pakënaqura sa i përket grumbullimit të mbeturinave. Sipas hulumtimit të organizatës DEMI/USAID, 83% e banorëve të Skenderajt janë shprehur të pakënaqur me menaxhimin e deponive ilegale të mbeturinave, përderisa 78% e tyre janë shprehur të pakënaqur me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave në komunën dhe vendbanimet e tyre.⁷

- 4. Mungesa e lokacionit për varreza.** Mungesa e lokacionit për varreza në qytetin e Skenderajt është shfaqur si problem në vitet e fundit. Komuna nuk ka arritur të gjejë lokacion të duhur për të zgjidhur këtë problematikë. Lokacioni aktual i varrezave nuk ka më shumë hapësirë. Kjo ka shtyrë qytetarët që të afërmit e vdekur t'i varrosin në fshatra. Kjo është paraqitur si shqetësim i banorëve edhe në mbledhjet publike të komunës me qytetarët.⁸
- 5. Mungesa e transportit për nxënësit.** Asnjë fshat në Komunën e Skenderajt nuk e ka në funksion transportin për nxënësit të cilët udhëtojnë mbi 4 km për në shkollë. Ky obligim i komunës është i paraparë me Ligjin për Shkollimin Parauniversitar.⁹ Nga mungesa e shërbimeve për transport, shumë nxënësve u duhet të udhëtojnë në këmbë mbi 4 km, siç është rasti në fshatin Likoc ku nxënësve të lagjeve “Musliu” dhe “Veseli” u duhet të udhëtojnë çdo ditë mbi 6 km. Në situatë të ngjashme janë edhe nxënësit e lagjes “Deliu” në fshatin Abri dhe ata të lagjes “Jashari” në fshatin Açarevë e po ashtu edhe tërë fshati Kotorr dhe Radishevë.
- 6. Mungesa e trotuareve.** Problemi i mungesës së trotuareve në Komunën e Skenderajt është një problem tjetër i cili i përcjell banorët e kësaj komune. Vetëm në qytet janë të rregulluar trotuaret ndërsa në fshatra dhe përgjatë rrugës magjistrale që lidh Skenderajin me Mitrovicën dhe Drenasin mungon trotuari. Situatë e njëjtë nga mungesa e trotuareve është në rrugën magjistrale Drenas-Skenderaj, pikërisht në fshatrat Polac dhe Makërrmal ku nxënësit janë të rrezikuar nga automjetet që kalojnë në këtë magjistrale.

⁷Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 20. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

⁸Komuna Skenderaj. Mbledhja publike me qytetarët, 27.06.2013. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Neës/U-mbajt-mbledhja-publike-ne-Skenderaj.aspx>

⁹Kuvendi i Kosovës. Ligji për Ndarjen e kufijve Administrativ të Komunave. Nr.03/L-041. Fq 27. Burimi: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L041_al.pdf

7. Ndotja e lumit Klina. Lumi “Klina”, i cili është lumi i vetëm që kalon nëpër qytetin e Skenderajt po ndotet vazhdimisht nga ujërat e zeza. Mungesa e kanalizimit në këtë komunë ka ndikuar që ujërat e zeza të derdhen në këtë lum, ku masës së ndotjes u shtohet edhe hedhja e mbeturinave. Përveç ndotjes, shtrati i lumit “Klina” i cili është dëmtuar në vërshimet e muajit mars të këtij viti, është rindërtuar vetëm në pjesë të caktuara. Kështu, në fazën e dytë të rindërtimit të lumit, Komuna e Skenderajt do të ndërtojë vetëm atë pjesë prej urës në rrugën “Ilaz Kodra” deri te ura në Klinë të Poshtme.¹⁰ Ndërsa rindërtimi i shtratit të lumit në zonën urbane, përkatësisht te parku afër stadiumit të qytetit, Komuna nuk e ka paraparë që ajo pjesë e dëmtuar të rindërtohet.¹¹

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Shkolla e vjetër në Likoc.** Kjo është shkolla e parë dhe njëkohësisht më e vjetra në rajonin e Drenicës. Ajo është ndërtuar në vitin 1924 me punën vullnetare të banorëve. Në të vijonin mësimet nxënës të rajonit të Drenicës, ndërsa mësuesit ishin nga Kukësi, Elbasani, Tetova, Tirana dhe Shkupi. Me vendim të Komunës së Skenderajt, në vitin 2004 ky objekt është shpallur monument i trashëgimisë kulturore dhe historike. Por, në prill të këtij viti Komuna ka marr vendim që ta rrënoj.¹² Banorët e Likocit dhe të fshatrave përreth tij kanë bllokuar punimet për rrënimin e shkollës duke ndaluar kështu këtë veprim të komunës.
- 2. Kompleksi memorial “Adem Jashari”.** Ky kompleks gjendet në fshatin Prekaz. Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për shpalljen e Kompleksit Memorial "Adem Jashari" me interes të veçantë nacional në vitin 2007.¹³ Në këtë kompleks përveç që gjinden shtëpitë muze aty janë edhe të gjitha varret e të rënëve të familjes Jashari dhe të dëshmoreve të tjerë të Prekazit. Për çdo vit mijëra qytetarë nga trevat e ndryshme vinë për ta vizituar këtë vend.

¹⁰Komuna Skenderaj. Burimi:<http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Neës/Ka-nisur-faza-e-dyte-e-ndertimit-te-shtratit-te-lu.aspx>

¹¹Agjencia e lajmeve “Kosova live”, Vazhdon rregullimi I shtratit të lumit Klina në Skenderaj, 20.07.2013. Burimi: <http://ëëë.kosovalive360.com/nis-faza-e-dyte-e-ndertimit-te-shtratit-ne-lumin-klina-te-skenderajt.html#sthash.SugbmT8E.dpbs>


¹²Lajm.“Absurd, vendimi për rrënimin e shkollës në Likoc”, 10 prill 2013. Burimi: <http://WWW.lajmonline.com/sq/Kombetare/Absurd-vendimi-per-rrenimin-e-shkolles-ne-Likocf-22252>

¹³Gazeta Zyrtare, Ligji për shpalljen e kompleksit përkujtimor Adem Jashari, 01.03.2007. Burimi: http://WWW.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=121&Itemid=28&lang=sq

Trendet Buxhetore në Komunën e Skenderajt

Komuna e Skenderajt në vitin 2013 ka planifikuar 9.9 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010 buxheti i kësaj komune ka shënuar ngritje prej 719 mijë euro. Viti 2012 ka shënuar pikën më të ulët të të hyrave vetanake (571 mijë euro). Kjo për shkak se në vitin 2011 dhe 2010 komuna ka përfituar nga koncesionet e pronave komunale. Sipas Komunës së Skenderajt, nga 8.700 prona të regjistruara në këtë komunë rreth 5.200 (60%) prej tyre janë pagues të rregullt të tatimit ndërsa 2.600 (30%) e tyre janë pagues të kohë pas kohshëm. Rreth 1.400 prona janë të paregjistruara.¹⁴ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm¹⁵ ka vërejtur këto parregullsi tek të hyrat vetanake: 1) ekzistenca e faturimit automatik vetëm tek të hyrat nga tatimi në pronë; 2) mungesa e regjistrimit të debitorëve sipas llojit të taksave etj.

Figure 1. Buxheti i Komunës së Skenderajt 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?skenderaj/2013>

¹⁴Komuna e Skenderajt, Përgjigje në Kërkesën e Instituti GAP, 15 Gusht 2013

¹⁵ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Skenderajt Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 03 Shtator 2013 http://www.oag-rks.org/repository/docs/Skenderaj_Report_ALB_922644.pdf

Në bazë të grafikonit mbi ndarjet buxhetore shohim se për dallim nga kategoria e “Pagave dhe Mëditjeve” që kanë pësuar një ngritje, investimet kapitale kanë pësuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2010. Krahasuar me vitin 2010, investimet kapitale më 2013 kanë rënë për 1 milion euro apo 29%.

Figura 2. Ndarjet Buxhetore 2010-2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2014-2016, Komuna e Skenderajt planifikon t'i rrisë të hyrat kryesisht nga rritja e grantit qeveritar. Në anën tjetër, nga të gjitha kategoritë e shpenzimeve ato kapitale pritet të kenë një rritje më të theksuar me rreth prej 11%.

Tabela 1. Buxheti 2014-2016

	2014	2015	2016
Të hyrat totale	10.295.577	10.558.040	10.770.341
Të hyrat vetanake	599.777	617.770	630.125
Grantet	9.695.800	9.940.270	10.140.216
Shpenzimet Totale	10.295.577	10.558.038	10.637.339
Pagat dhe Mëditjet	6.455.975	6.520.534	6.524.534
Mallrat dhe Shërbimet	901.331	919.357	887.974
Shpenzimet Komunale	171.025	174.445	168.450
Subvencionet dhe Transferet	161.000	164.220	166.097
Shpenzimet Kapitale	2.606.246	2.779.482	2.890.284

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulamtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe kampanjave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulamtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të respektueshme për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Prishtinës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulamtive më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012), etj.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.